



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 15, Datë 10.02.2022

PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 27.01.2022
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 27.01.2022, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 27.01.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erjon NEXHIPI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 27.01.2022

Kryesuesi i mbledhjes është kryetari i Këshillit z. Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes : në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 22

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 22 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z. Sotiraq Filo dhe drejtorë të ekzekutivit

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 4

Pika 1 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Pika e parë e rendit të ditës, për miratimin e rendit të ditës, ka ndonjë pyetje?

Këshilltare I. Nikaj: Unë mendoj Kryetar se duhet të shqyrtojmë fillimisht çështjen e sigurisë nga qentë përpara se të vazhdohet me pikat e tjera të rendit të ditës. Ne marrim shqetësime përditë, e kemi folur edhe disa herë këtë çështje, jemi duke shkelur të drejtat e njeriut, është detyrim kushtetues siguria publike mbi të gjitha. Në çdo kënd të Korçës jo vetëm atje ku banoj unë marr shqetësime çdo ditë nga qytetarët. Ftoj ekzekutivin të thotë çfarë është në gjendje ai të bëjë dhe nëse nuk është në gjendje kujt t'i drejtohem.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Në fakt unë e kam ngritur shumë herë këtë çështje në çdo mbledhje. Një situatë e pakëndshme më ndodhi edhe mua jo më larg se mëngjesin e sotëm me dy grupe qensh, përpara dy shkollave ku mbi të gjitha frekuentohen nga fëmijët, ia u çova edhe ju video, madje disa ditë më parë pati edhe disa reagime individuale që as me ato nuk jam dakort, por që grupe njerëzish mendojnë ndryshe dhe bëjnë ato veprime eliminimi. Kërkohet një zgjidhje afatgjatë dhe e qëndrueshme për këtë problem se është vërtet shqetësues. Të mbështes në kauzën tënde, por mendoj ta shohim në fund të mbledhjes.

Këshilltare I. Nikaj: Në fund të mbledhjes e pamë dhe herën e kaluar dhe nuk u bë gjë, shqetësimet vazhdojnë dhe situata po bëhet e pamenaxhueshme. Jo më larg se mbledhjen e

kaluar një këshilltare ka shfaqur shqetësimin e lëndimit të disa qytetarëve dhe nuk u mor asnjë masë, tufat janë shtuar, edhe ata që kanë qënë me zot janë bërë pa zot, disa qytetarë iu hedhin ushqim me vend e pa vend dhe kjo ka bërë që sjellja e tyre të jetë bërë e pamenaxhueshme.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, dakort, do e hedhim në votim, në lidhje me rendin e ditës ka ndonjë gjë për të shtuar? Ka një propozim nga znj.Irena Nikaj për të shtuar në diskutim këtë çështje, e hedhim në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALEVE TË MBLEDHJEVE TË KALUARA.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Hedhim në votim proçesverbalet e mbledhjeve të kaluara.

Hidhen në votim dhe miratohen

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës.

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIU DHËN 1 – 31 DHJETOR 2021.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj.Irena Nikaj mund të merrni fjalën.

Këshilltare I.Nikaj: Propozoj dhënie e ndihmës ekonomike nga 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike dhe nga fondi i buxhetit vendor. Për muajin dhjetor 2021, janë 48 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar, fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike është një fond i cili i shtohet çeljes faktike nga lista e përfituesve të ndihmës ekonomike, të përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme”

konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Përzgjedhja bëhet duke u bazuar kryesisht në miratuarat me VKB, nëpërmjet vizitave në familje në terren dhe duke verifikuar gjendjen social-ekonomike të familjeve aplikante. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet rome dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 4 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr. 5 për kriteret e 6%, datë 28.01.2021. Për muajin dhjetor 2021, është në dispozicion fondë prej 179.260 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, nga sistemi i pikëzimit. Nga ky fond, përfitojnë 48 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifikë të miratuara, në shumën 109.060 lekë. Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 24 familje, në shumën 30.264 lekë. Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 139.324 lekë. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, sipas kriterëve specifikë të miratuara 25 familje, me fond prej 66.040 lekë. Ju ftoj ta miratojmë si pikë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka tjetër për të shtuar nga këshilltarët apo nga ekzekutivi? Vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, ME 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE PËR VITIN 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj.Irena Nikaj përsëri është fjala juaj.

Këshilltari I.Nikaj: Atëherë, për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për vitin 2022 janë përcaktuar në projektvendim kriteret ku këshilltarët mund t'i shohin, ku një nga kriteret është edhe pika 2 që thotë se familja para se të përzgjidhet për t'u trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht dhe do të vlerësohen nga një komision i ngritur nga Administratorët Shoqëror dhe Përgjegjës të Pagesave. Në vlerësimin tim kjo pikë nuk përbën një kriter, por mund të vendoset tek pjesa e hyrjes së projektvendimit dhe jo si pikë në kriterë, sepse gjithë ata që do paraqiten tek Administratori do të jenë të përcaktuar sipas pikave që ne kemi miratuar. Me këtë propozim ju ftoj ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra po flasim për pikën 2 tek projektvendimi jo tek relacioni?

Këshilltari I.Nikaj: Po, për tek projektvendimi po flas, se relacioni nuk ka kritere. Këta paraqiten të gjithë dhe ata që plotësojnë kritere për ndihmë ekonomike ndahen për ndihmë ekonomike, ata që nuk i plotësojnë këto kritere ndahen në nivelet e tjera pastaj.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra, do verifikohen në vend? Alfons mund të na sqarosh pak.

Ekzekutivi A.Vranishti: Paraprakisht familja, përpara se të hyjë në vlerësim duhet të plotësojë kriteret dhe ky është një nga kriteret.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Vlerësimi si është, vete në vend?

Ekzekutivi A.Vranishti: Po shkon në terren.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përfaqësuesit e Komisionit shkojnë në vend? Kjo është një pikë që duhet ta plotësojë?

Ekzekutivi A.Vranishti: Po.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kriteret kanë erdhur nga Shërbimi Social Shtetëror dhe nuk kemi ne të drejtë t'i heqim. Bëhet një miratim vetëm formal i tyre. Fondi 6% vjen nga buxheti i shtetit dhe përveç atij verifikimit të parë që është bërë kërkohet edhe një verifikim më pranë nga Administratori në terren.

Këshilltari I.Nikaj: Po kjo mund të vendoset në kushtëzimet e përgjithshme, jo në kriteret, kriter për mua është familje pa të ardhura, në nevojë, një kriter i verifikueshëm.

Ekzekutivi A.Vranishti: Në momentin që ne na vjen në sistemin e pikëzimit kështu, ne nuk ndërhyjmë dot në kriteret, sepse kështu na kanë erdhur, në bazë të saj ne duhet të plotësojmë një formular që s'mund ta ndryshojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra e shprehur këtu jam shumë dakort me zyshen se duket sikur çfarë po bëjnë këta, por që lidhet me këtë plotësimin e formularit në vend.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Lista me kriteret profesore dhe formulimi na ka erdhur nga institucioni qendror, nga Ministria dhe Shërbimi Social Shtetëror dhe ne thjesht bëjmë një miratim formal me sa kuptoj unë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ndonjë diskutim tjetër ka?

Këshilltare E.Tare: Edhe tek pika 6 e cila thotë familje rome të cilat kanë probleme me transferimin dhe regjistrimin duhet shtuar edhe egjiptiane aty jo vetë rome.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jemi tek fondi 6 % akoma, ti po flet për materialin tjetër, edhe një herë po e them, fondi 6 % i ka të përcaktuara kriteret nga institucionet qendrore.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët e tjerë? Kalojmë në votim. Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR PËR VITIN 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj.Irena Nikaj mund të vazhdoni.

Këshilltare I.Nikaj: Kemi përsëri miratimin e disa kriterëve që do të trajtohen nga fondi i buxhetit vendor. Përfitues të fondit nga buxheti i Pushtetit Vendor do të jenë, familjet të cilat nuk kanë përfitur nga sistemi i pikëzimit dhe nga 6% i fondit të kushtëzuar, por kualifikohen si përfitues për shkak të kushteve shumë të vështira social-ekonomike dhe vështirësive të veçanta sociale. Lista e familjeve do të miratohet me Vendim të Këshillit Bashkiak në bazë të kriterëve specifikë që propozohen në projekt-vendim dhe që janë përcaktuar duke marrë parasysh situatën konkrete social-ekonomike të disa nën/kategorive. Edhe këto kriterë janë të përcaktuara nga Ministria?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po.

Këshilltare I.Nikaj: Dakort atëherë, ju ftoj për miratim.

Këshilltare E.Tare: Këtu bëhet fjalë për atë ndryshimin që përmenda, për pikën 6, por edhe tek pika 4 duhet të përfshihen edhe vajzat nëna.

Ekzekutivi A.Vranishti: Ato i kualifikon direkt sistemi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ja një moment të sqarohemi tani, këto kriteret janë gjithë ata që kanë përfitur nga e para, e dyta, e treta, të gjitha janë këtu. Ne i miratim edhe në pikën më përpara ato, ndërkohë tani kemi ata që nuk kanë përfitur nga ato të parat.

Këshilltare E.Tare: Erjon, aty është vetëm rome, duhet edhe egjiptiane.

Ekzekutivi A.Vranishti: Nëse familjet dalin me pikë të pamjaftueshme tek pjesa e parë, ajo e fondit 6%, iu jepet mundësia të përfshihen tek tjetra, për të bërë pastaj ndryshime duhet folur me Shërbimin Social Shtetëror.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Bazuar në ato ç'ka u thanë sot, mund të bëjmë një komunikim me Shërbimin Social Shtetëror nëse mund të ndërhyjmë ose jo dhe marrim një përgjigje përfundimtare.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, Alfons mund të dalësh ta sqarosh dhe e shtyjme për pak më vonë këtë pikë.

Pika 6 e rendit të ditës.

PËR RISHQYRTIMIN E VKB NR. 147, DATË 22.12.2021 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR 2022 TË BASHKISË KORÇË".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqytjes Financiare, kryetari këtu ka ngelur pak evaziv gjithmonë.

Këshilltare M.Nene: Ishte thjesht një sqarim ligjor.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, kalojmë në votim atëherë.
Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të ditës.

PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga ekzekutivi ka diçka për të shtuar?

Ekzekutivi S.Prifti: Duke u bazuar tek miratimi i kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe tek buxheti vjetor 2023 Bashkia Korçë është detyrim ligjor që ti paraqesim Këshillit të Bashkisë përgatitjen e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në lidhje me një çështje që u ngrit edhe herën e kaluar, sesi do të zgjidhjet situata me tarifat e prapambetura, se di është parashikuar diçka këtu?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: I kemi tek pika tjetër e rendit të ditës këto parashikime.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, nga Komisioni apo këshilltarët ka ndonjë gjë për të shtuar? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 8 e rendit të ditës

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.137, DATË 25.11.2021 PËR “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2022”.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare, znj.Mamica Nene mund të vazhdoni.

Këshilltare M.Nene: Referuar diskutimeve të këshilltarëve në Këshillin e Bashkisë në lidhje me njoftimet dhe detyrimet e akumuluar ndër vite për kryefamiljarët të cilët nuk kanë një kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me ndërmarrjen U.K.KO dhe nuk kanë qënë të mirëinformuar në lidhje me detyrimet vendore familjare, duhet ti paguajnë këto për një periudhë duke filluar nga momenti që kanë bërë ndarje familjare apo kanë krijuar një ekonomi familjare të ndarë nga ajo e mëparëshmja. Nisur nga fakti që vlera e detyrimeve të mbledhura ndër vite është në vlerë të konsiderueshme për ekonominë e një familjeje si dhe duke pasur prioritet lehtësimin dhe krijimin e kushteve të favorshme duke shtrirë në kohë afatin e likujdimit për këto detyrime, propozohet lidhja e marrëveshjes së bashkëpunimit për likujdim me këste për tarifën vendore familjare të ketë një afat maksimal 5 vjeçar në përpjestim me shumën e detyrimit dhe periudhën kohore për të cilën familja rezulton debitore. Ju ftoj ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Një pyetje kam unë, është përlogaritur për afërsisht sa familje janë në këtë situatë dhe arsyet kryesore që janë të prapambetura këto pagesa?

Ekzekutivi S.Prifti: Tani nga ana e Bashkisë janë njoftuar të gjitha familjet të cilat nuk kanë një kontratë furnizimi me ujë të pijshëm, por që kanë një vlerë tarife që duhet të paguajnë dhe vlera është e faktueshme, por me database-in e ri duhen bërë disa ndarje për ta parë edhe njëherë gjendjen. Ndërkohë duke parë edhe kërkesat që na kanë erdhur nga disa këshilltarë dhe vlerat realisht të larta që iu takon këtyre familjeve për këtë periudhë menduam ta ndanim këtë mundësinë e pagesës në një periudhë 10 vjeçare.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Deri në sa vjet janë që kanë këtë detyrim?

Ekzekutivi S.Prifti: Nga 2011.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra i bie gati 10 vjet. Pra, një familje tani i bie të paguajë 3 vitet e parë.

Ekzekutivi S.Prifti: Nuk është e thënë, se ka familje që e kanë periudhën edhe më të vogël, jo 10 vjeçare domethënë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: E kuptoj, kemi ndonjë të dhënë për këtë situatën?

Ekzekutivi S.Prifti: Jo, ja u shpjegova punën me database-in, tani do të plotësojmë database-in e gjendjes civile, gjithsesi familjet janë njoftuar vazhdimisht.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Qëllimi është që të gjendet një mënyrë për të lehtësuar sadopak qytetarët dhe nga ana tjetër të krijohet edhe një formë arkëtimi të këtyre të ardhurave se janë të domosdoshme. Dihet që kanë qënë në vështirësi prandaj nuk i kanë paguar, por përsëri presioni që iu bëjmë duhet patur pak studim, të dhëna ku do shkojmë e me rradhë. Gjithsesi ka diçka për të shtuar nga këshilltarët?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 9 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM TË SIPËRFAQEVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga ekzekutivi kemi diçka?

Ekzekutivi A.Dishnica: Unë doja të thoja se ka një lapsus në material, në pjesën e legjislacionit të cituar, është theksuar pika e, ndërkohë që duhet saktësuar se është pika e 1/e e saktë. Ky është një material që referuar ligjit për pyjet miratohen në Këshillin e Bashkisë të gjitha sipërfaqet që kanë kaluar fillimisht në pronësi të Bashkisë dhe pastaj hap pas hapi në varësi të kontratave që lidhen vijnë edhe materiale të tilla. Meqënëse ka patur një ndryshim tek sipërfaqet pyjore e sjella në Bashki, ky material ka qënë më parë i miratuar, por u soll edhe njëherë për miratim për shkak të ndryshimeve që iu përmenda.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kemi dy Komisione në këtë pikë, Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujërave, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Biodiversitetit dhe Komisioni i Rregullores,

Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë, z. Gjergji Kristo keni diçka për të sugjeruar?

Këshilltar Gj.Kristo: Jo, nuk kemi çfarë të sugjerojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, kalojmë në votim. Besoj ky saktësimi i legjislacionit lidhet më tepër me numrin e votave që duhet për miratim, me shumicë këshilli 25 vota, jo shumicë e thjeshtë.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 10 e rendit të ditës.

PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E SKEMËS TË SHPËRBLIMEVE TË EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2021 TË QENDRA SPORTIVE KORÇË SH.A.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ju ftoj të kalojmë si Asamble pronari për emërimin dhe miratimin e skemës të shpërblimeve të ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2021 të Qendra Sportive Korçë sh.a.

Përfaqesues i QSK L.Qirinxhi: Kemi përgatitur materialin për emërimin dhe miratimin e dy ekspertëve kontabel për QSK sipas legjislacionit përkatës.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kryetari i grupit, z. Emiljano Muharem mund të vazhdoni me propozimet tuaja për dy emrat që kërkohen.

Këshilltari E.Muharem: Dy emrat që ne propozojmë janë Etleva Ashiku dhe Ilda Ekonomi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, votojmë atëherë për emrin e parë, znj.Etleva Ashiku.

Hidhet në votim dhe miratohet emri i parë, Etleva Ashiku.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 2

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Propozimi i dytë znj.Ilda Ekonomi, vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet emri i dytë, Ilda Ekonomi.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 11 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E TRAJTIMIT USHQIMOR DHE DIETAVE PËR EKIPIN E PARË DHE AKADEMINË "SKËNDERBEU" PËR VITIN 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Një pyetje kam këtu unë, vazhdojmë të qëndrojmë ne si Asamble apo na vjen nga ekzekutivi ky material?

Përfaqësues i QSK L.Qirinxhi: Ne si QSK ja paraqitim Asamblesë si material, herë të tjera e kemi miratuar në Asamble.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëherë për miratimin e trajtimit ushqimor dhe dietave për Ekipin e Parë dhe Skënderbeu, mund të na i shtjelloni pak?

Përfaqësues i QSK L.Qirinxhi: Po patjetër, nën cilësinë e Administratorit të Qendra Sportive Korçë sh.a, në mbështetje të Ekipit të Parë dhe Akademisë "Skënderbeu", në nenin 135 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 " Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare ", i ndryshuar si dhe në Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë duke ju referuar listës të federimit numri i të cilës i kalon 30 persona, nevojës që ekipi i Skënderbeut ka për mbështetje financiare në arritjen e rezultateve, kërkoj miratimin e fondit në vlerën 50.000 lekë në muaj për person, për 30 sportistë, futbollistë dhe staf për 10 muaj dhe dietën ditore për Ekipin e Parë dhe Akademinë " Skenderbeu ".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Sa shkon mbështetja për një sportist?

Përfaqësues i QSK L.Qirinxhi: 50 mijë lek në muaj për trajtimin ushqimor dhe pastaj edhe transfertat në lëvizje që bëjnë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po parashikimi në total sa është?

Përfaqësues i QSK L.Qirinxhi: Shkon diku tek 20 milion në vit edhe për Ekipin e parë edhe për Skënderbeun.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po kjo është e ndarë sa i takon Ekipit të Parë, sa i takon Skënderbeut?

Përfaqësues i QSK L.Qirinxhi: Nuk është fikse.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po nga eksperiencia edhe mund ta dini.

Përfaqësues i QSK L.Qirinxhi: Po nga eksperiencia Ekipi i Parë ka më tepër shpenzime, me përlllogaritjet tona shkon diku tek 80 mijë lek në muaj për një sportist, në total.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mirë, goxha mbështetje iu dhënkemi. Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët Vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 29

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tek pika më parë, më kujtoi sekretarja e Këshillit, kemi miratuar vetëm emrat e ekspertëve ndërkohë që kemi edhe pjesën e dytë të materialit pa miratuar, skemën e shpërblimit. Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 29

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: I rikthehem pikës për kriteret që do të trajtohen nga fondi i buxhetit vendor.

Ekzekutivi A.Vranishti: Pasi u diskutua edhe me Shërbimin Social Shtetëror mund të jetë edhe një lapsus, i cili mund të ndryshojë, mund të shtohet ajo fjala egjiptiane që u kërkua.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, atëherë bashkë me shtesën që u diskutua kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 29

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 12 e rendit të ditës

KËRKESË-ANKESA.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kemi një kërkesë të parë, që në fakt unë kam qënë në kontakt edhe me grupet e interesit, ne si Këshill diskutojmë dhe marrim vendime të ndryshme dhe kjo

nuk na kushtëzon të diskutojmë edhe për çështje të tilla si kjo që na është paraqitur, e cila sigurisht ka impakt mbi gjithë qytetin dhe rajonin. Ka erdhur një kërkesë bashkëpunimi dhe solidariteti nga Dhoma Vendore e Avokatisë Korçë. Unë do lexoj vetëm atë pjesë që na prek direkt tek kërkesa që të mos e zgjasim më tepër. Në emër të të gjithë avokatëve që janë anëtarë të Dhomës së Avokatisë Korçë, në përbërje të së cilës janë rregjistruar mbi 300 avokatë të licensuar, nga të cilët mbi 120 që ushtrojnë aktivitet, me mbulim territorial për gjithë Prefekturën Korçë, me rrethet Ersekë, Korçë, Devoll dhe Pogradec dhe me këtë shtrirje të madhe territoriale, po ju parashtrijmë si më poshtë: Duke marrë shkas nga publikimi i lajmit për propozimin e KLGJ-së, për Hartën e Re Gjqësore e cila konsiston në reduktimin e numrit të gjykatave në shkallë vendi dhe midis të tjerave edhe krijimin e një gjykate të vetme Apeli Civil dhe Penal (të juridiksionit të përgjithshëm me seli në Tiranë), apo mbylljen e gjykatave administrative të shkallëve të para, në Rrethet Gjqësore ku janë atashuar, shprehim kundërshtimin dhe indignatën tonë në lidhje me këtë projekt që cënon një nga parimet bazë të zhvillimit të procesit të rregullt ligjor, siç është gjykimi brenda një afati ligjor të arsyeshëm, vështirëson aksesin e qytetarëve, rrit kostot e tyre, që lidhen me përfaqësimin e tyre në gjykatë (rriten ndjeshëm shpenzimet e transportit, përveç atyre të përfaqësimit me avokat) dhe për më tepër, qytetit tonë i largohen dy institucione shumë të rëndësishëm, duke përbërë rrezik për rruthje të ndjeshme jo vetëm të administratës, por pakësimi i këtyre shërbimeve, rrezikon edhe rruthje të numrit të popullsisë në rajon si dhe rrjedhje të profesionistëve drejt kryeqytetit. Pra, Harta e Re Gjqësore mbyll Gjykatën e Apelit Korçë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, shërbimet e të cilave do të kryhen nga një Gjykatë Apeli në Tiranë si dhe nga dy Gjykata Administrative të Shkallës së Parë, në Tiranë dhe në Lushnjë. Ky është konstatimi i problemit, letra është e gjatë, por ne kemi përfaqësues prezent sot që mund të na thonë diçka më tepër. Ne jemi të lumtur të kemi pjesë të Këshillit tonë, pjesëtarë nga komuniteti i avokatëve, por njëkohësisht edhe vet institucioni që ne përfaqësojmë siç është Bashkia ka një lidhje të ngushtë me gjykatat. Unë personalisht them se ky qytet apo ky rajon ku ne bëjmë pjesë përbëjnë një qendër të rëndësishme të Shqipërisë Juglindore, duke patur këto institucione apo edhe institucione të tjera si universiteti. Për më shumë po i jap fjalën një nga përfaqësueset e Dhomës së Avokatëve të Korçës.

Përfaqësuese e Dhomës së Avokatisë E.Miço: Fillimisht doja t'iu falenderoja për mundësinë që na dhatë për të dëgjuar shqetësimin tonë, ne këtu jemi 4 përfaqësues të Dhomës Vendore të Avokatisë Korçë, Kryetari i Dhomës dhe ne 3 avokatët e tjerë. Ne jemi sot përpara jush, por njëkohësisht kemi paraqitur edhe një material ku kërkojmë mbështetjen tuaj në kundërshtimin tonë ndaj Hartës së Re Gjqësore. Harta e Re Gjqësore është propozim nga Këshilli i Lartë Gjqësor, i drejtuar tek Ministria e Drejtësisë dhe do të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Aktualisht kjo hartë është në fazë këshillimi me grupet e interesit. Ne sigurisht jemi një nga grupet e interesit, por interesi kryesor që preket dhe shkelet nga kjo hartë është ai i qytetarëve. Referuar parimeve bazë mbi të cilat ngrihet ky propozim, në fakt ato parime janë shkelur nga mënyra sesi është disponuar me mbylljen e Gjykatës së Apelit në qytetin e Korçës dhe njëkohësisht të Gjykatës Administrative. Nëse kjo hartë do të miratohet nuk do të ketë më Gjykatë Apeli në Korçë, por do të ketë vetëm një Gjykatë në Tiranë dhe një Gjykatë tjetër në Lushnjë dhe të gjitha çështjet e Korçës do të shkojnë në këto dy Gjykata. Pra, një qytetar i Korçës për një çështje të thjeshtë administrative qoftë për një pension apo një heqje patente do t'i drejtohet Lushnjës. Kjo cënon parimin e drejtësisë për të mos vonuar asnjë çështje ndaj qytetarëve, sidomos në Gjykatën e Apelit. Një shembull i keq i tyre është Administrativja e Apelit në Tiranë, ku një çështje do minimalisht 5 vjet për t'u mbyllur. Për të mos e zgjatur më

shumë, ka shumë rrethana të tjera për t'u treguar dhe diskutuar, por meqënëse jemi të gjithë sëbashku në fazën e këshillimit, le të përqijemi që këto Gjykata të mos mbyllen dhe kjo për disa kritere shumë të rëndësishme. Së pari, Korça është qyteti juglindor më i largët nga kryeqyteti, kjo krijon një vonesë të jashtëzakonshme një qytetari që niset nga Korça për një çështje që do të gjykohet në Tiranë, ku minimalisht do 4 orë e gjysëm udhëtim plus trafiku dhe gjithë vonesat që krijohen deri në mbërritje. Këto janë shkelje të parimit të drejtësisë, për të mos përmendur pastaj rrugën dhe kohën që do t'i duhet një qytetari për të shkuar për të kundërshtuar një vendim deri në Lushnjë, kostot e të gjitha me rradhë. Faza në të cilën është momentalisht Harta e Re Gjyqësore është faza ku mund të ndërhyjmë, duke shtruar argumenta dhe duke përbërë një zë të fuqishëm bashkë. Në fund të kërkesës ne kemi shtruar 3 kërkesa, së pari kemi kërkuar të ishim pjesë e mbledhjes dhe ju falenderojmë që na bëtë pjesë e rendit të ditës për t'u dëgjuar kërkesa jonë, së dyti, iu kemi kërkuar bashkëpunim, pra të dalim me një dokument të përbashkët duke shprehur qëndrimin tonë të përbashkët për të kundërshtuar miratimin e kësaj harte nëse ju e miratoni mbështetjen që ju do të na jepni qoftë drejtuar Ministrisë apo edhe Këshillit të Ministrave që do të bëjë edhe miratimin e saj. Gjithashtu në datën 4 shkurt nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë do të zhvillojnë në Korçë një tryezë për të diskutuar aktin dhe ne do të dëshironim të ishit edhe ju, një përfaqësi e juaja për të përfaqësuar mendimin e Këshillit. Kjo ishte pak a shumë ajo që ne donim të shpalosnim në emër të Dhomës Vendore të Avokatisë.

Kryetari i Dhomës Vendore të Avokatisë A.Lena: Edhe unë ju falenderoj për mundësinë që na dhatë për të dëgjuar fjalën tonë. Përsa i përket atyre që tha kolegja e cila është marrë me grupin e punës të pushtetit lokal dhe të gjitha ato që ajo përmendi qëndrojnë. Përveç kësaj duhet të keni parasysh se çdo gjyq që do zhvillohet pas miratimit e atij akti në çfarëdo lloj padie që pushteti lokal do të jetë, do të ketë shpenzime ekstra dhe pika tjetër është ulja e vlerës së qytetit pasi duke munguar këto institucione kryesore siç janë gjykatat, duke lënë vetëm një Gjykatë të Shkallës së Parë. Mbajtja e gjykatave është një interes i përbashkët i të gjithëve ne, përveç se një vlerë e rëndësishme për qytetin tonë dhe besoj se me mbështetjen tuaj mendoj se mund të arrijmë të mbajmë këto dy gjykata në qytetin tonë. Siç e përmendi edhe kolegja kjo është një distancë goxha e largët qoftë nga Lushnja, qoftë nga Tirana për të kryer gjykime nga qytetarët e rrethit tonë, kështu që kjo është edhe një interes edhe më i lartë sesa thjesht të dilni në mbështetje të avokatëve.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë doja të pyesja diçka, unë e kam lexuar me kujdes të gjithë kërkesë tuaj dhe e kuptoj shqetësimin, por tani duke qënë se diskutimin e kam ndjekur pak nga larg dhe nuk jam shumë i informuar, çfarë argumenta janë paraqitur për të justifikuar këtë Hartë të Re Gjyqësore? Unë kam ndjekur vetëm pjesën që ka mungesa nga ana e gjyqtarëve për shkak të Vettingut, po besoj se këto problematika që keni ngritur, distanca, koha, kosto të gjitha këto besoj se dihen dhe mendoj se janë diskutuar, tani çfarë argumenta jepen dhe sigurisht që në fund do t'i sugjeroja Këshillit që në bashkëpunim me ju të përgatitin një kërkesë drejtuar Ministrisë të Drejtësisë si organi që i shqyrton dhe i diskuton këto shqetësime dhe do të sugjeroja të ishin pjesë e këtij diskutimi dhe takimit konsultues që qenka në datën 4 shkurt edhe për t'u informuar, por edhe për të ngritur shqetësimet në takim edhe pjesëtarë të Këshillit.

Kryetari i Dhomës Vendore të Avokatisë A.Lena: Tani në pjesën filluese, shpjeguese të materialit të KLGJ-së, KLGJ-ja thotë se një gjykatë, mesatarja e gjyqtarëve duhet të jetë 22.5 gjyqtarë për 100 mijë banorë, ndërkohë që mesatarja e gjyqtarëve është 12.5; e dyta, KLGJ-ja

thotë se aksesimi i çdo individi në gjykatë duhet të jetë me transport publik 1 orë e gjysëm, ndërkohë që me Hartën e Re Gjyqësore me transport publik jo me makina secili nga ju e di shumë mire se çdo të thotë të ikësh me transport publik nga Tirana në Korçë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po tani të gjithë e dimë që nga Tirana në Korçë është më shumë se 1 orë e gjysëm.

Kryetari i Dhomës Vendore të Avokatisë A.Lena: Ka edhe pjesë teknike që ne i përmendëm pak ato që dimë t'i kthejmë përgjigje, por dimë që edhe Ministri i Drejtësisë në momentin e parë që është propozuar kjo hartë nuk ka qënë Ministër dhe ka qënë kundër sikurse ne, ndërkohë që tani akoma nuk ka një reagim të saktë për këtë çështje, sepse jemi akoma në fazë konsultimi. Të metat e hartës gjyqësore janë evidente dhe të dukshme dhe në tavolinën e rumbullakët të 4 shkurtit ne do t'i shpalosim gjithë pikat tona. Do të jemi në kontakt të vazhdueshëm edhe me ju për t'iu ofruar gjithë asistencën tonë për këtë pjesë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Faleminderit, po i jap fjalën një këshilltari pastaj vazhdojmë përsëri me ju.

Këshilltari E.Petriti: Faleminderit z.Kryetar, tani unë po flas si këshilltar edhe pse jam në kontakt edhe me avokatët si pjesë e profesionit. U renditën një sërë të metash të atij propozimi që është ngritur dhe që çënojnë interesat e qytetarëve dhe të goxha grupeve të interesit të qytetit të Korçës, gjithsesi kriteret kryesore janë dy: largësia dhe numri i gjyqtarëve për banorë, ku ky i dyti është i diskutueshëm sepse Qarku i Korçës ka një shtrirje nga Leskoviku deri në Përrenjas dhe për kriterin e parë e thamë që është i pazbatueshëm. Ndërsa shkakun nga lart është mungesa totale e gjyqtarëve, prokurorëve në sistem, nga 400 e ca që duhet të jenë janë rreth 200 e pak. Megjithatë kjo nuk do të thotë që të penalizohet një komunitet që është Qarku i Korçës, pavarësisht se diskutohen interesat e Bashkisë Korçë, por është njësi vendore më me peshë e Qarkut dhe normalisht ka një peshë kryesore. Unë mendoj se ne si Këshill duhet të dalim me një rezolutë mbështetjeje, sepse e kemi atë kompetencë dhe patjetër që duhet të bëhemi pjesë edhe e asaj tryeze në mbështetje të grupit të interesit dhe ashtu siç thanë edhe kolegët janë shteruese arsyet pse ne duhet t'i kemi këto gjykata në qytetin tonë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort jam edhe unë në ndërtimin e një rezolute, por edhe për të tjerë elementë që ne parimisht mund t'i miratojmë dhe të dalim në një opsion të përbashkët edhe me Dhomën e Avokatisë Korçë për të përpiluar një rezolutë për të kundërshtuar këtë hartë që impakton gjithë aktorët dhe faktorët e rajonit tonë. Unë një pyetje kisha Drejtoreshën e Zyrës Juridike, sa çështje ka Bashkia Korçë në Gjykatën Administrative?

Ekzekutivi A.Dishnica: Momentalisht kemi 3 gjyqe në ditë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra rreth 60 në muaj, ku këto çështje mund të mos jenë nga i njëjti jurist, sepse varen nga përgatitjet e secilit, por e rëndësishme për mua është impakti financiar në shpenzimet për proceset gjyqësore për t'i ndjekur ato do të jetë i madh, jo më pastaj distanca e gjitha me rradhë. Kështu në fund cikli i përsëritjes së gjyqeve do të zgjasë dhe me një kalkulim të thjeshtë karburanti dhe dieta etj, shpenzime kohe mblidhen shumë faktorë bashkë për të forcuar këtë kundërshtim. Për mua përse kohë ekzistojnë gjykatat në këtë vend gjithmonë ka patur

shkallë të dytë të gjyqimit dhe të kthehemi pas në kohë dhe shërbim të qytetarëve më duket pak e padrejtë.

Këshilltare I.Nikaj: Edhe unë kisha këtë shqetësim, kjo lëvizje rrezikon nivelin e demokracisë në vendin tonë dhe ndërkohë nëse flasim për rastin e reformës në drejtësi kjo është autogol.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Të flasim për rezolutën tani, mos dilni jashtë kontekstit për të bërë vlerësimet tuaja.

Këshilltare I.Nikaj: Po do i bëj unë edhe vlerësimet e mia, a po flasin gjithë aktorët dhe faktorët që preken? Nëse ju keni këndvështrimin tuaj unë do flas për demokracinë se kjo më shqetëson.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Profesore, ne dëgjuam nga avokatët e pranishëm se ka nisur një proces konsultimesh për këtë pjesë.

Këshilltari E.Petriti: Kryetar ky proces ka tre vjet që ka filluar.

Përfaqësuese e Dhomës së Avokatisë E.Miço: Normalisht konsultimi duhet të ishte bërë më përpara se t'i çohet Ministrisë si propozim, por megjithatë tani që jemi ngritur për kundërshtim konkretisht grupi ynë u zhvilluan edhe këto takime, sepse më parë as nuk na ishte thënë dhe as nuk ishte publikuar asgjë nëpër faqet e tyre zyrtare.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kush po i bën konsultimet?

Përfaqësuese e Dhomës së Avokatisë E.Miço: KLGJ-ja dhe Ministria. Ndërkohë ne jemi duke i bërë presion Ministrisë të mos e pranojë këtë hartë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Fjala presion është pak jo e përshtatshme.

Këshilltar E.Petriti: Presion në kuptimin pozitiv kryetar. Të lutem Kryetar, merr dhe pyet dy njerëz që kanë çështje në Gjykatën e Apelit të Tiranës, sa vjet kanë për një pension që nuk e ka zgjidhur ende.

Këshilltare I.Nikaj: Z.Kryetar, sot është data 27 deri në datën 4 shkurt ju mendoni se të gjithë këta që e morën sot lajmin do të përgatiten të kenë gati argumentat?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka muaj ky diskutim, sot i erdhi propozimi Këshillit për të dhënë mbështetjen, fjalën e tij.

Këshilltare I.Nikaj: Po pra, kërkojnë solidaritet, tani ne duhet të ishim njoftuar më parë, sepse në këtë periudhë ne na duhet të përgatisim vetëm argumentat, ju nuk dini arsyet kryesore të propozuesve.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Profesore të lutem, e keni lexuar apo jo materialin që na ka erdhur?

Këshilltare I.Nikaj: E kam lexuar.

Përfaqësuese e Dhomës së Avokatisë E.Miço: Ne mund t'ia u vemë në dispozicion materialin ku ata mbrojnë propozimin e tyre.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Professore Irena keni ndonjë diskutim tjetër? Jeni dakort me propozimin tonë?

Këshilltare I.Nikaj: Jo nuk jam dakort.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, çfarë propozoni ju?

Këshilltare I.Nikaj: Unë propozoj të jemi të gjithë gati për të mbështetur atë që kërkohet.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po të gjithë për atë gjë jemi, edhe njëherë, kemi një propozim që në përputhje me Rregulloren e Këshillit, edhe me sekretaren e Këshillit kam folur, por edhe me Drejtoreshën e Zyrës Juridike dhe do të dalim me një rezolutë si Këshill Bashkiak.

Këshilltare I.Nikaj: Unë jam dakort.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po pra për këtë po flisnim, keni ndonjë propozim për të shtuar për këtë çështje; ndonjë fjalë, dëshironi të jeni në grupin e punës që do të ngrihet për këtë rezolutë?

Këshilltare I.Nikaj: Po.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Shumë mirë, ne me çfarë është propozuar nga KLGJ-ja nuk jemi dakort dhe po e themi këtë gjë, nuk doli njeri të thoshte se është dakort.

Këshilltare I.Nikaj: Z.Kryetar ajo që unë thashë se ne argumentat e atyre që e kanë propozuar këtë hartë nuk i kemi, këto që qëndrojnë, qëndrojnë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po çfarë rëndësie ka? Sikur edhe asnjë argument mos dimë, thjesht fakti që duan t'i largojnë këto gjykata nga qyteti ynë na bën të reagojmë dhe le të mos dimë asnjë lloj argumenti. T'i jap pak fjalën zotërisë dhe më pas vazhdojmë përsëri bashkë.

Përfaqësues i Dhomës së Avokatisë L.Tabaku: Në nenin 25 të ligjit për organizimin territorial të gjykatave përcaktohet që në hartëzimin e gjykatave të rretheve gjyqësore merren parasysh dhe zhvillimi demografik, zhvillimi urban i qyteteve, largësitë, distancat, kushtet e transportit merret parasysh edhe performanca e gjykatave. Argumentat e KLGJ-së janë krejt të kundërta me ato dhe konkretisht gjykatat e Korçës kanë performancë shumë të mirë, megjithë problemet që kanë. Tani ata duan të standartizojnë përshpejtimin e gjykimeve, pra nuk munden që për shkak të performancës së ulët të gjykatave në rrethet e tjera të dëmtojnë qytetin e Korçës; e dyta, qyteti i Korçës ka një zhvillim urban të dukshëm dhe kjo është objektive, këta nuk mund të dëmtojnë pjesën urbane, pra nuk mund të hiqen këto gjykata edhe në aspektin administrativ dhe rëndësinë që ka si qytet, si zonë juglindore; së treti popullsia e qytetit është rritur dhe këtë e vërtetojnë censuset dhe kjo është një nga kushtet që nuk duhen mbyllur gjykatat, ndërkohë ata bëjnë të

kundërtën edhe e pranojnë që është rritur popullsia dhe thonë që numri i çështjeve është ulur; Korça është një nga qytetet më të largëta; Korça tashmë është një qytet i zhvilluar në shumë dimensione dhe kjo e dëmton atë si në aspektin e biznesit, si në aspektin e qytetarëve dhe ndërkohë duhet të ishit ju të nderuar këshilltarë si Parlamenti i qytetit që duhet të ishit të parët që duhet të informoheshit dhe të gjitha këto në mënyrë të përmbledhur na afekton të gjithëve, si qytetarë, por edhe si institucione. Të gjitha studimet që janë bërë janë në të kundërt me rezultatet që ata kanë nxjerrë, kështu që, nëse ju do të na mbështesin me një rezolutë do të jemi brenda logjikës dhe brenda realitetit që ka marrë zhvillimi i qytetit të Korçës.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë paraprkasht, ju falenderoj që e sollët këtë shqetësim dhe besoj se mbështetja është apo nuk është për ju, po është edhe për veten tonë në rradhë të parë dhe këtu nuk flasim vetëm për qytetin tonë, po flasim për gjithë rajonin ku imagjinoni një njësi administrative siç është Leskoviku, se ne flasim për distancën nga Korça, por Leskovikut i duhen edhe disa orë më shumë. Pra, mendoj se mbështetja nuk është vetëm për një komunitet të rëndësishëm siç janë avokatët në këtë rast, por është mbështetje për veten dhe banorët që ne përfaqësojmë.

Këshilltari R.Themeli: Pyetja ime e parë është nëse është apo jo akoma Korça, qendër administrative rajonale, sepse unë mendoj që është dhe nuk e di ku mund të dalim me këto lëvizje të tilla në mbështetje të avokatëve, sepse lëvizje të tilla ndodhin kudo në botë, por ne nuk duhet të lejojmë që të ndodhë diçka që nuk është në interes të qytetarëve tanë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Një gjë konstruktive që mendoj unë është të caktojmë një grup këshilltarësh që kanë njohuri nga ana ligjore, por jo vetëm ligjore, të flasin edhe me përfaqësuesit dhe të shkruajnë një dokument që t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë dhe e dyta, bashkë me avokatët të marrin pjesë ky grup në tryezën që do të zhvillohet në 4 shkurt kur thonë përfaqësuesit e Dhomës dhe t'i ngrenë më fort aty këto diskutime që ne po bëjmë, këto dy gjëra janë që mund të bëjmë për momentin, caktoni një grup njerëzish, kush do merret, çfarë do të bëjnë dhe mënyrën sesi do ta miratoni këtë dokument dhe si do ta dërgoni këtë dokument në emër të Këshillit.

Këshilltari E.Petriti: Unë propozoj që ne këtu të kërkojmë një rezolutë mbështetëse për shqetësimin që na ka erdhur, sepse dokumenti dëshmon edhe punën tonë të kryer.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po pra, në mënyrë ligjore ngrihet Komisioni dhe në fillim të javës, të hënë ose të martë bëjmë mbledhjen, e caktojmë që sot formën në mënyrë digitale, sepse ky Komision do t'ia dërgojë këtij Këshilli për miratim, thjesht do e miratojmë, se ne mund të miratojmë në parim shumë gjëra dhe pastaj në formulim mund të na dalin probleme, le të jemi korrektë, kështu fitojmë edhe afatin kohor që është data 4, sepse mbështetja sugjeroj të dalë para atij takimi.

Këshilltari R.Themeli: Unë propozoj që të bëhet rezoluta pa shoqërinë e avokatëve, Korça ka prestigj dhe duhet t'i ketë këto gjykata, s'mund të vejë Korça me një propozim në interes të këtij grupi interesi, ndërkohë që duhet ta kundërshtojmë ne fort që të mos ndodhë kjo hartë për qytetin tonë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani ti mendoj se ne duhet të shkojmë vetëm me argumentin që Korça ka prestigj dhe duhet t'i ketë këto gjykata?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, z.Themeli, ti je që propozimi ynë të jetë i veçantë, propozim tjetër ka?

Këshilltare I.Nikaj: Unë kam një pyetje, kjo harta e re ku do të miratohet?

Përfaqësuese e Dhomës së Avokatisë E.Miço: Në Këshillin e Ministrave.

Këshilltare I.Nikaj: Pra ku mund të goditet?

Përfaqësuese e Dhomës së Avokatisë E.Miço: Nëse do merret një akt normativ nga Këshilli i Ministrave mundësia është të goditet në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Bëhet një diskutim individual mes pjesëmarrësve i paqartë për t'u dëgjuar në transmetim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ju lutem mos flisni midis jush, ta dëgjojmë dhe ta kuptojmë të gjithë atë që thuhet.

Këshilltare I.Nikaj: Duke dëgjuar debatet që po ngriheshin po pyesja pak znj.Miço se ku mund të goditet ky vendim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Profesore nuk jemi në atë stad, të sqarohemi njer ne si Këshill çfarë do të bëjmë.

Këshilltare I.Nikaj: Po interesohesha si qytetare se çfarë ndodh në raste të tilla dhe se çfarë duhet të bëjmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ajo që duhet të bëjmë ne brenda institucionit tonë është rezoluta, nuk mund të dalim ne me pankarta në rrugë, ju lutem jo secili sipas qejfit tani.

Përfaqësuese e Dhomës së Avokatisë E.Miço: Ne jemi profesionistë dhe meqënëse e njohim sistemi më mirë, erdhëm këtu, por erdhëm edhe si qytetarë, nuk kemi erdhur thjesht për interesat tona. Ta keni të qartë nëse kemi erdhur thjesht për interesat tona mos na mbështesni.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ju lutem qetësi!! Nga këshilltarë të tjerë ka argumenta, propozime për të shtuar?

Këshilltari P.Bello: Për mua është shumë e qartë situata, nuk duhet pranuar ajo hartë në mënyrë absolute.

Këshilltare E.Menkshi: Duke qënë se gjykatat, por edhe institucione të tjera siç është universiteti janë të rëndësishme për qytetin, po edhe për rajonin mendoj se duhet të tregojmë mbështetjen tonë për këto çështje, Këshilli duhet të japë mbështetjen e tij në disa institucione të tjera të cilat duhet të vazhdojnë aktivitetet e tyre në rajonin tonë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëherë, propozimi është ky, ngremë një Komision për të përgatitur një rezolutë, e cila do të shpërndahet në mënyrë digitale tek këshilltarët dhe do të votohet në mënyrë digitale dhe si afat i saktë është dita e hënë. Propozime për Komisionin e Këshillit Bashkiak, që do të jetë grupi i punës, do të mbledhë dhe punojë argumentat cilët do të jenë? Se pastaj vendimi patjetër që do të jetë i Këshillit Bashkiak z.Raqi, do të jetë vendimi ynë i përbashkët dhe mendoj se nuk ka ndonjë gjë të keqe të dalin në mbrojtje të një grupi të caktuar interesi se kemi marrë vendime këtu edhe për ndërtuesit, edhe për arkitektët, për të gjithë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po merrni disa argumenta bindës tani, mos votoni në mbrojtje të Dhomës së Avokatisë, bëjeni për të mirën e qytetarëve dhe qytetit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Marrim propozimet ju lutem.

Këshilltare A.Verushi: Unë mendoj se duke ditur edhe formimin e këshilltarëve propozimet të jenë: Raqi Themeli, Ermir Petriti, Irena Nikaj, Gjergji Kristo dhe Shkëlqim Kajmaku.

Këshilltari E.Petriti: z.Kajmaku nuk është, propozoj Emiljanon në vend të tij.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, tjetër propozim?

Këshilltare I.Nikaj: Unë propozoj edhe Kryetarin e Këshillit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort se mund ta bëjmë edhe me 7 anëtarë. I jap fjalën z.Arben.

Kryetari i Dhomës Vendore të Avokatisë A.Lena: Një diçka të vogël sa për ndihmë, ne kemi ngritur një grup pune prej një muaji në lidhje me këtë çështje, i cili do t'iu asistojë në mënyrë maksimale për përgatitjen e rezolutës sipas gjithë rrugës ligjore. Formulimi i saj kuptohet që ju do jepni pikat kryesore dhe ne do t'iu mbështesim nga ana juridike që nga dita e nesërme.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë mendoj se Komisioni në fund të kësaj mbledhjeje të qëndrojë pak për të ndarë disa gjëra që të avancojë puna që sot.

Këshilltari E.Petriti: Kush ishte Komisioni edhe njëherë?

Sekretare E.Naçi: Komisioni përbëhet nga Raqi Themeli, Ermir Petriti, Irena Nikaj, Gjergji Kristo, Erjon Nexhipi, Emiljano Muharem, Ana Verushi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort dhe përcaktuam ditën e hënë për mbledhjen online. Një tjetër kërkesë e kemi nga Shoqata Gorë-Opar e Bashkuar, për vendosjen e emërit të rrugës Turan-Dajmanec të policit Pëllumb Horanlliu i rënë në krye të detyrës dhe kanë dhënë shpjegimet e tyre që besoj e keni lexuar. Tani kjo besoj duhet parë nga ana ligjore dhe i duhet dhënë një përgjigje kur të shqyrtohet si rast.

Pika 13 e rendit të ditës.

PIKA TË NDRYSHME

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tani, tek kjo pikë i jap fjalën këshilltares znj.Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj: Po s'ka nevojë për sqarime të tjera, e thashë njëherë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po më mirë se nuk ishte Kryetari i Bashkisë qëpari.

Këshilltare I.Nikaj: Problematika qëndron tek qentë, që unë e kam theksuar edhe herë të tjera dhe shqetësimet e qytetarëve sa vijnë dhe shtohen dhe megjithë zërin e ngritur këtu nuk ka asnjë ndryshim. Duke ditur edhe situatën tani të së ftohtit dhe borës njerëzit nuk dijnë çfarë të bëjnë, të shohin rrugën ku të kalojnë me kujdes apo të ruhen nga qentë. Në emër të Kushtetutës unë kërkoj të merren masa.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë patjetër që e mbështes profesore Irenën në këtë çështje dhe e kam ngritur edhe unë zërin për këtë çështje dhe jo më larg se sot në mëngjes, para dy shkollave konkretisht jam përballur me një tufë të madhe qensh 15-20 qenër ku kalojnë dhe lëvizin fëmijë.

Këshilltari D.Hoxha: Sa fëmijë janë prekur nga ta?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dejvi të lutem, kujt i dhimbsen t'i marrë ti mbajë në shtëpi, qyteti duhet të jetë i pastër nga kafshët pa zot. Shëndeti publik prevalon mbi çdo lloj të drejte tjetër.

Këshilltari R.Themeli: Propozimi cili është?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Propozimi është të zbatohet ligji.

Diskutimet në sallë nuk të lejojnë qartë të kuptosh çfarë është thënë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani të flas edhe unë pak, se janë thënë shumë gjëra të pavërteta, nuk është e vërtetë që nuk kemi bërë asgjë, ndërkohë që ne kemi filluar procesin e sterilizimit dhe vaksinimit, në vitin 2020 janë sterilizuar dhe matrikulluar 225 qenër dhe në vitin 2021 janë sterilizuar 120 qenër. Pavarësisht këtyre jam dakort që ky është një fenomen shqetësues, ka momente që ata janë agresivë, ka momente kur nuk janë agresivë. Nga informacioni që më erdhi tani meqënëse u diskutua për t'u bërë pjesë e rendit të ditës kjo pike, na sjellin edhe tufa qensh nuk e dimë nga ku, nga qytetet e tjera, 15-20 qenër i shkarkojnë në unazën e qytetit dhe shtohet popullata e qenve të rrugës. Kjo është situata, çfarë kemi bërë dhe çfarë ndodh në rrugë. Tani pres sugjerimet dhe opinionet tuaja se jemi bërë edhe objekt sulmesh dhe lajmesh të pavërteta, nëse nuk shqetëson dikë kjo situatë shqetëson dikë tjetër, sepse opinionet e njerëzve janë të ndara dhe në fund është edhe ligji që nuk pyet për opinione. Tani lajmet janë të pavërteta, se këto janë të rënda që Bashkia po helmon qen të matrikulluar që s'ka logjikë, edhe t'i sterilizojmë edhe t'i helmojmë nga ana tjetër, të harxhojmë 50-60 mijë lek për secilin dhe nga ana tjetër t'i helmojmë. Ne kemi një buxhet të caktuar për këtë çështje, por si duket nuk është i mjaftueshëm për sasinë e qenëve që kemi sot në rrugë dhe si duket do jetë edhe më i madh përderisa na sjellin edhe të tjerë nga qytetet e tjera. Ju kam kërkuar edhe ndonjë sugjerim animalistëve që të bëhen pjesë e kësaj fushatës së sterilizim vaksinimit dhe pse jo edhe të përpiqen ti heqin nga situata e rrugës duke i adoptuar, duke i marrë në kujdes, tani nuk e di si është zgjidhja.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë dua t'iu pyes thjesht, iu duket normale të shihni një tufë me 20 qenër të vërtitet nëpër qytet kudo?

Këshilltari K.Andrea: Po nuk mund të shpreheni siç u shprehët ju herën e kaluar direkt me zbatim të ligjit për eleminimin e tyre.

Këshilltare E.Tare: Po flet kështu Kristi se ty nuk të kanë dale ndonjëherë të të kafshojnë fëmijët.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani situata nuk është kaq bardhë e zi dhe realisht është shqetësuese dhe kemi marrë edhe ato komentet e padrejta ndaj Bashkisë, po me të drejtën e tyre animalistët për çështjen që mbrojnë. Ne kemi një qendër të vogël, e cila shërben vetëm për qëllim sterilizim dhe vaksinim, nuk është për të mbajtur një numër të madh qensh aty. Problemi është realisht i madh dhe dua mendimin tuaj, nuk po i gjejmë dot zgjidhje.

Këshilltari E.Petriti: Të ngrihen më shumë qendra të tilla atëherë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po ja i ngritëm edhe disa qendra të tilla, po nuk mjaftojnë nëse situata vazhdon edhe na sjellin të tjerë nga jashtë qytetit.

Këshilltare I.Nikaj: Unë i kuptoj të gjithë ata që duan t'i mbrojnë dhe ju vjen keq, por ama nuk kemi pse ne të rrezikojmë dhe të na ngjiten e zbresin nëpër pallate çdo moment të ditës vetëm se duan t'i lenë të lirë kështu dhe kemi të drejtë të themi edhe një fjalë më shumë. Tani a jemi në gjendje ne të marrim vendime në të mirë të të gjithëve? Unë nga pikëpamja e bashkësisë, mendoj se duhen mbledhur dhe duhen vendosur në një vend dhe të vendoset një rregull, sepse ju mund të vazhdoni t'i sterilizoni, por ata do vazhdojnë në habitatin e tyre natyror dhe ne të gjithë do flasim përsëri për të njëjtin problem.

Vazhdon debati në mënyrë të zhurmshme.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

